



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr.2784/3 Prot

Tiranë më 06.09.2018

VENDIM

Nr. 29, datë 06.09.2018

“Për disa ndryshime në Formularin nr.4 të Vendimit nr.8 datë 26.03.2018 të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës”

Bazuar në nenin 38, pika 1/ç, h dhe në nenin 49, pika 1/ç të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”; pas një korrespondence tepër të gjatë shkresore dhe elektronike me Filialin e UT-së, Sarandë dhe me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe sqarimeve përkatëse me Administratorin e UT-së, në Formularin nr.4 ‘Numri i punonjësve për efekt të pagave për vitin 2018’ në Vendimin e Senatit Akademik nr. 8, datë 26.03.2017 “Për miratimin e projekt buxhetit të vitit buxhetor 2018 të UT”, Senatit Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e tij të datës 06.09.2018,

VENDOSI:

1. Të miratojë këto ndryshime në Formularin nr.4 “Numri i punonjësve për efekt të pagave për vitin 2018” në Vendimin nr.8 datë 26.03.2018 të Senatit Akademik të UT-së, në 2(dy) njësi në përbërje të UT-së, konkretisht si më poshtë:

a. Për Filialin e UT-së, Sarandë:

- Në kollonën “Numri i planifikuar Punonjës ndihmës akademikë në organikë” nga 2 (dy) punonjës të bëhen 3 (tre) punonjës. Kjo shtesë do të jetë një vend pune i emërtesës “punonjës biblioteke”.
- Në kollonën “Numri i planifikuar Punonjës ndihmës administrative (me kontratë)”, nga 0 punonjës të bëhen 3(tre) punonjës.

b. Për Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar:

- Në kollonën “Numri i planifikuar Punonjës ndihmës administrative (me kontratë)”, nga 0 punonjës të bëhet 1(një) punonjës.

2. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit të UT, për miratimin e ndryshimeve në numrin e personelit, sipas pikës 1 të këtij vendimi si dhe për mbulimin e shpenzimeve për pozicionet e sipërcituara, në buxhetin e planifikuar të vitit 2018 të njërive shpenzuese.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF. DR. MYNYR KONI